

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 9270 Rep.

NR. 2939 Kol.

T.

KONTRATË SHITESË KONCESIONI

PËR

NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË  
LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGËTISË DHE  
ENERGJETIKËS BASHKIMIN E SHOQËRIVE “POLISTAMP SYSTEM” S.R.L.  
& “ENERGIA & TERRITORIO” S.R.L. & “ADVISOR C. ENERGY” SH.P.K.,  
MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1133, DATË  
18.11.2009, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “VELESHICA 1”,  
“VELESHICA 2”, “VELESHICA 3”, “VELESHICA 4”, “VELESHICA 5”,  
“VELESHICA 6”, “SLLOVË” DHE “BJESHKË”

Në Tiranë, më datë 31, muaji Shkurt, viti 2013 (dy mijë e trembëdhjetë), para  
meje noter JULIAN ZHELEGU, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë  
në Rr. “Pjetër Bogdani”, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**, që më poshtë do të quhet  
“**AUTORITET KONTRAKTUES**”, përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të  
Ministrave nr. 883, datë 12.12.2007, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për  
dhënie me koncension të hidrocentralit “Veleshica”, dhe miratimin e bonusit në  
procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, përfaqësuar nga z.Florjon  
Mima, i datëlindjes \_\_\_\_\_ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për  
identitetin e të cilit u sigurova nga

DHE

Shoqëria “**Veleshica Energy**” Shpk, me seli në Bulevardi Bajram Curri, Pallati Deja,  
Kati I, Tiranë. me NUIS L01423028L, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Ubaldo Baglioni, i  
datëlindjes \_\_\_\_\_ me banim ne \_\_\_\_\_, i identifikuar me  
karten e identitetit \_\_\_\_\_ madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

Në këtë kontratë, palëve të mësipërme do t’iu bëhet referim së bashku si “Palët” ose  
veçmas si “Pala”.

“Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 54 (pesëdhjetekatër) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit. Afati i ndërtimit është 16 muaj si e parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 1, bashkëlidhur.”

## Neni 2

Kjo kontrate shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata shtesë e koncesionit u hartua në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi u lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe une noteria e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

## PALËT

### AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë  
dhe Energjetikës

P

Z. RIQJON MULLIA

### KONCESIONARI

Shoqërive “Veleshica Energy” sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

Z. Ibaldo POPPI

NOTERI